

AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TË KOSOVËS
BANKARSKI I PLATNI AUTORITET KOSOVA
BANKING AND PAYMENTS AUTHORITY OF KOSOVO

Sistemi i Pagesave në Kosovë

Prishtinë, 2002

Sistemi Ndërbankar i Pagesave

Sistemi i Kliringut Ndërbankar (SKN) është themeluar në maj 2001 në mënyrë që të lehtësohen operacionet e pagesave vendore duke i kanalizuar ato nëpërmjet sistemit bankar. Kjo ishte e mundur për shkak të një tradite dhe kulture ekzistuese bankare dhe gjithashtu si rezultat i shpejtë i zhvillimit të marrëdhënieve të mira midis bankave dhe klientëve të tyre. Sistemi i Kliringut u zhvillua dhe u bë plotësisht funksional në fund të vitit 2001. Rritja e shpejtë e operacioneve përmes SKN tregoi se besimi i kosovarëve në sistemin bankar lokal ishte rritur.

Fillimisht u prezantua një sistem manual ku secila bankë komerciale kishte përgatitur pagesat ndërbankare në një disketë dhe në një kohë të rënë dakord, shkëmbyen disketat në BPK. Në fund të vitit 2001, sistemi fillestar u zëvendësua me një version elektronik të sistemit të pagesave, Sistemi Elektronik i Transfereve Ndërbankare, për të lidhur të gjitha bankat pjesëmarrëse komerciale nëpërmjet linjave dial-up për transmetimin e urdhërpagesave ndërbankare. Kur Sistemi i Kliringut Ndërbankar u prezantua, gjithashtu është themeluar Komiteti Këshillues i Pagesave Ndërbankare (KKPN) për të adresuar të gjitha çështjet që lidhen me pagesat jo-cash në Kosovë. KKPN kryesohet nga Drejtori i Departamenti të Sistemit të Kliringut Ndërbankar të BPK-së dhe anëtarë nga të gjitha bankat pjesëmarrëse komerciale.

Në bashkëpunim të ngushtë me KKPN, ishte e mundur të zhvillohen të gjitha procedurat e operacioneve ditore të SKN dhe çështje tjera, si format standarde të SKN, strukturën e tarifave të SKN, rregullat operative të SKN miratimi i sistemit për standardizimin e numrave të llogarive bankare të bazuar në IBAN dhe forma të përbashkëta të urdhrave të transferit për pagesat ndërbankare dhe bilaterale.

Grupi punues teknik i KKPN është themeluar me pjesëmarrjen e ekspertëve të teknologjisë informative nga të gjitha bankat për të lehtësuar zbatimin e mëtejshëm të Sistemi Elektronik i Transfereve Ndërbankare.

Numri i transfereve ndërbankare

Përsa i përket volumit të operacioneve të ICS, numri si dhe shuma totale e transaksioneve tregoi rritje të qëndrueshme. Në fund të vitit numri mesatar ditor i transaksioneve arriti gjysmën nga të gjitha urdhërpagesat të ekzekutuara në kohë reale. Gjatë kësaj periudhe janë kryer pagesat masive të pagave për subjekte të ndryshme përmes kliringut. Procesi i ndërrimit të valutës, në mënyrë të konsiderueshme ka ndikuar në numrin e operacioneve të ICS, veçanërisht gjatë muajit dhjetor 2001. Rritja me shpejtësi e vëllimit të operacioneve të ICS ka paraqitur nevojën për automatizimin dhe modernizimin e mëtejshëm të departamentit ICS.

Tabla 13.

| Transferet ndërbankare, Maj-Dhjetor 2001 | | | | mijera DEM |
|---|------------------|-------------------------|-----------------------------|---------------------------|
| Periudha | Numri i Pagesave | Shuma totale e pagesave | Mesatarja ditore e pagesave | Shuma mesatare E pagesave |
| Maj | 204 | 12,269 | 10.20 | 60 |
| Qershor | 403 | 11,724 | 20.15 | 29 |
| Korrik | 492 | 18,666 | 24.60 | 38 |
| Gusht | 556 | 13,212 | 27.80 | 24 |
| Shtator | 651 | 16,370 | 32.55 | 25 |
| Tetor | 890 | 13,999 | 44.50 | 16 |
| Nentor | 825 | 31,114 | 41.25 | 38 |
| Dhjetor | 1,103 | 51,310 | 55.15 | 47 |
| TOTAL | 5,124 | 168,664 | 32.03 | 35 |

Transferet ndërbankare, Maj-Dhjetor 2001

